



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

---

## BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE NË MALTË, VITI AKADEMIK 2018-2019

Qeveria e Maltës përmes Ministrisë për Mjedisin, Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Ndryshimin e Klimës ka shpallur programin e bursave për studentët e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pasuniversitare për çështjet klimatike në Universitetin e Maltës për vitin akademik 2018-2019.

Bursat e studimit ofrohen në fushat e mëposhtme:

- Zbutja e ndryshimeve klimatike dhe transporti i ulët i karbonit;
- Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike për të rritur elasticitetin për ruajtjen e burimeve të gjalla detare;
- Qeverisja e ndryshimeve klimatike në kontekstin e shteteve dhe territoreve të vogla ishullore;

Skema e akordimit të bursave është pjesërisht pjesë e detyrimeve të Maltës sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet Klimatike (UNFCCC) për të ofruar mbështetje për shtetet në zhvillim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të bëjnë aplikimin online dhe të dorëzojnë dokumentacionin hard copy pranë Universitetit të Maltës brenda datës **25 Maj 2018** që është edhe afati i fundit për aplikim në adresën e mëposhtme:

*University of Malta  
Msida, MSD 2080  
Malta  
Phone: + 35623402340*

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, Ju lutemi referojuni adresave në web-site:

<https://www.um.edu.mt/newspoint/noticeboard/opportunities/2018/05/scholarshipsinclimateaction>  
[https://www.um.edu.mt/\\_data/assets/pdf\\_file/0006/348261/climateactionscholarshipsum2018.pdf](https://www.um.edu.mt/_data/assets/pdf_file/0006/348261/climateactionscholarshipsum2018.pdf)

Gjithashtu, për sqarime të tjera kandidatët mund të kontaktojnë me Zyren Ndërkombëtare të Universitetit të Maltës në adresën e-mailit: [interanational@um.edu.mt](mailto:interanational@um.edu.mt)

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhet thirrja për aplikim me udhëzimet përkatëse.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**